



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2020:062003

Datë: 28.09.2021

Numri i dokumentit: 02221763

P.nr.1027/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Adnan Kamberi, në çështjen penale kundër të pandehurve A. H. dhe S. D. nga P..., për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 1 lidhur me nenin 31, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), i akuzuar sipas aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e Urdhërit Ndëshkimor, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, të Prokurorisë Themelore në Prishtinë / Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.1808/2020 të datës 29.05.2020, jashtë seancës me datë 27.09.2021, mori:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, PP.II.nr.1808/2020 të datës 29.05.2020, për shqiptimin e urdhërit ndëshkimor,

Andaj, gjykata konform nenit 495 të KPPRK-së, jep:

URDHËR NDËSHKIMOR

Kundër të pandehurve:

- 1. A. H.**, nga i ati E. dhe nëna F. e gjinisë M., i lindur me dt. ..., me vendbanim në fsh. M..., O..., me numër personal: ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.
- 2. S. D.**, nga i ati I. dhe nëna H. e gjinisë Sh., i lindur me dt. ..., me vendbanim në fsh. Sh..., komuna e Kamenicës, me numër personal: ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTOR

Sepse:

Të pandehurit A. H. dhe S. D. pas marrëveshjes paraprake, në intervalin kohor që nga data 27.01.2020 rreth orës 21.10 min deri me datë 14.02.2020, në magjistralen Prishtinë-Mitrovicë, më konkretisht në fshatin Mazgit të Obiliqit pas marrëveshjes paraprake me qëllim që e përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme, veti ti sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm kishin vjedhur – kishin mbushur me derivate veturat Golf 3 ngjyrë e zezë, pa targa të regjistrimit si dhe veturën Mercedes ngjyrë e bronzte dhe atë në pompat e derivateve: Shell Petroll, Eksfis dhe Sherif Petroll dhe kishin ikur pa paguar, duke ju shkaktuar të njëjtëve dëm të konsiderueshëm material-;

- **Me këtë në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 1 lidhur me nenin 31, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).**

Andaj, gjykata konform nenit 1, 2, 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69, 314 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si dhe neneve 365, 493 dhe 495 të KPPRK-së, të pandehurve, i'u shqipton:

DËNIM ME GJOBË

1. Për të pandehurit A. H. i shqipton dënim me gjobë në shumën prej 200 (dyqind) Euro, të cilin dënim është i obliguar që ta paguajë në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës se prerë të këtij aktgjykimi.

Në rast se i pandehuri nuk e paguan dënimin e shqiptuar, atëherë konform nenit 43 par.3 të KPRK ndaj të njëjtit dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim me burgim **duke llogaritur çdo 20 (njëzet) euro me 1 (një) ditë burg.**

2. Për të pandehurit S. D. i shqipton dënim me gjobë në shumën prej 200 (dyqind) Euro, të cilin dënim është i obliguar që ta paguajë në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës se prerë të këtij aktgjykimi.

Në rast se i pandehuri nuk e paguan dënimin e shqiptuar, atëherë konform nenit 43 par.3 të KPRK ndaj të njëjtit dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim me burgim **duke llogaritur çdo 20 (njëzet) euro me 1 (një) ditë burg.**

3. Obligohen: të pandehurit që në emër të paushallit gjyqësor gjykatës t'i kompensojë secili veq e veq shumën prej 30 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit me detyrim.

4. Pala e dëmtuar: për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë ka paraqitur aktakuzën PP.II.nr.1808/2020 të datës 29.05.2020, kundër të pandehurve A.H. dhe S. D. nga Prishtina, për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 1 lidhur me nenin 31, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Gjykatës i është propozuar që kundër të pandehurit të lëshoj Urdhërin Ndëshkimor me arsyetimin e besueshëm nga kallëzimi penal dhe provat e bashkangjitura lidhur me besueshmërinë e aktakuzës së prokurorisë në drejtim të vërtetimit të fakteve se i pandehuri vërtetë e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes e konform nenit 493 të KPPRK-së, Gjyqtari i vetëm gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495 të KPPRK-së dhe mori vendim që ta pranoj kërkesën për dhënien e Urdhërit Ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës si: kallëzimi penal dt. 08.05.2020, raporti fillestar i incidentit dt. 27.01.2020, raporti i oficerit dt. 27.01.2020, procesverbal mbi intervistimin e ankuesit A. K. dt. 27.01.2020, raporti i policit hetues dt. 27.01.2020, foto dokumentacioni pjesë e shkresave të lëndës, raporti fillestar i incidentit dt. 01.02.2020, procesverbal mbi intervistimin e viktimës – ankuesit F. J. dt. 01.02.2020, raporti i zyrtarit policor dt. 01.02.2020, raporti fillestar i incidentit dt. 13.02.2020, raporti i oficerit dt. 14.02.2020, procesverbal mbi intervistimin e ankuesit A. H. dt. 14.02.2020, kupon fiskal dt. 13.02.2020, raporti fillestar i incidentit dt. 14.02.2020, raporti i oficerit dt. 14.02.2020, procesverbal mbi intervistimin e dëshmitarit S. E. dt. 14.02.2020, procesverbal mbi intervistimin e të dyshuarit A. H. dt. 18.02.2020, procesverbal mbi intervistimin e të dyshuarit S. D. dt. 18.02.2020, të gjitha këto janë prova të mjaftueshme me të cilat vërtetohet se të pandehurit kanë kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

Andaj, Gjykata duke u bazuar në këto prova të besueshme vërtetoi se veprimet e të pandehurve ekzistojnë elementet e veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 1 lidhur me nenin 31, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), për këtë edhe i shqiptoi urdhërin ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale, dhe paushallit gjyqësor u mor konform nenit 450 par. 1 dhe 2 nënpar. 2.6 të KPPRK.

Në bazë të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPPRK-së, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Nga sa u tha me lartë, konform nenit 495 KPPRK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi..

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i përgjithshëm-Penal
P.nr. 1027/20; të datës 27.09.2021

G j y q t a r i
Adnan Kamberi

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi, i pandehuri apo mbrojtësi i tij mund të paraqesin kundërshtim në afatin prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të tij, në këtë gjykatë.